



Deri: Të gjithë operatorët e rrjeteve të komunikacioneve elektronike publike me pakot e regjistruara programore në Këshillin e radiodifuzionit

Për: Drejtorin

Lënda: Të drejtat dhe obligimet e operatorëve të rrjeteve komunikuese elektronike publike për plotësimin e tyre në pajtueshmëri me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele

Të nderuar,

Nga data 3 janar të vitit 2014 në fuqi hyjnë Ligji për media dhe Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe Ligji për media („Gazeta zyrtare e RM-ës “ nr. 184/2013).

Tekstet e të dy Ligjeve do të publikohen në ueb faqen e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (www.avmu.mk), Më poshtë në shkrim ju informojmë për detyrimet të operatorët e rrjeteve të komunikacioneve elektronike publike do ti kenë në pajtueshmëri me këto dy Ligje. Disa nga këto detyrime janë të njëjta si ato të deritanishmet, disa janë të modifikuara (të ndryshuara), ndërsa disa janë të reja:

1. Operatorët e rrjeteve të komunikuese elektronike publike janë të autorizuar dhe të detyruar që të bëjnë emetimin dhe riemetimin e serviseve programore;
2. Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele e Republikës së Maqedonisë (më tej në tekst Agjencia) ka të drejtë dhe për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen e programimeve të paketave programore të cilat i emetojnë operatorët e rrjeteve të komunikuese elektronike publike (Neni 28 nga Ligji);
3. Nëse serviset programore që rriemtohen përmes rrjeteve komunikuese elektronike publike titullohen në gjuhë të ndryshme nga gjuha në të cilën në mënyrë origjinale janë prodhuar, doemos duhet të titullohen në gjuhën maqedonase, ose në gjuhën e bashkësisë që nuk është shumicë ndërsa e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë përveç teleshopingut dhe reklamave (Neni 64 paragrafi 2 nga Ligji);
4. Secili operator para se të fillojë me ritransmetim të servisit programor, në Agjenci dorëzon fletëparaqitje për evidentim të tij në regjistrin e operatorit që ritransmetojnë pako programore dhe regjistrim të serviseve programore të cilat do t'i ritransmetojnë si tërësi në formë të pakos programore, me përmbajtje që e përcaktojnë Ligjin dhe aktet nënligjore të Agjencisë. Për ndryshimin e të dhënave të cekura në paragrafin (2) të këtij neni, operatori është i obliguar që ta njoftojë Agjencinë në afat prej 30 ditësh nga dita e shkaktimit të ndryshimit. (Neni 141 paragrafi 1, 2, 3 dhe 11 nga Ligji);
5. Operatorët janë të detyruar, në bazë të urdhrin të Agjencisë, menjëherë ti çkqyçin serviset programore të pa regjistruara (Neni 141 paragrafi 13 nga Ligji);

Nr _____

Shkup _____ viti
2014.



Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe
audiovizuele

Bul. VMRO nr.3
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë

Tel.(02) 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact @avmu.mk

6. Paraqitja dhe evidentimi në regjistrin e operatorëve që rriemetojnë paketave programore dhe regjistrimi i serviseve programore në formë të paketave programore mund të kryhet edhe në formë elektronike (Neni 141 paragrafi 16 nga Ligji);
7. Operatori i cili rritransmeton servis programor paguan kompensim vjetor për mbikqyrjen që e realizon Agjencia. Ai është i detyruar të paraqesë një raport mbi shumën e të ardhurave të përgjithshme vjetore më vonë deri më datë 15 mars të këtij viti, a ndërsa kompensimin vjetor ta paguaje më vonë deri më datë 15 prill të këtij viti (Neni 142 paragrafët 1, 3 dhe 4 nga Ligji);
8. Operatori mund të rritransmetojë servise programore të radiodifuzerëve vendas vetëm në zonën e servisit për të cilën radiodifuzerët kanë marrë leje për sigurimin e emetimit të radios dhe televizionit dhe në bazë të të drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta të rregulluara, (Neni 143 paragrafi 1 nga Ligji);
9. Të gjithë operatorët duhet të sigurojë që pakoja programore detyrimisht dhe falas t'i përmbajë serviset programore të servisit radiodifuziv publik që financohen nga taksa radiodifuzive (Neni 143 paragrafi 3 nga Ligji);
10. Operatori që rriemeton servise programore është i detyruar që në marrëveshjet me parapagesë që i lidh me parapaguesit e vet ta cekë pakon programore, përkatësisht listën e serviseve programore që i rriemetojnë për momentin (Neni 143 paragrafi 4 nga Ligji);
11. Operatori është i detyruar që të mbajë llogari për kontabilitetin e aktiviteteve të lidhura me rritransmetimin e serviseve programore (Neni 153 paragrafi 5 nga Ligji);
12. Nëse operatori themelon kanal internetin televiziv, sinjali dalës i ati kanali pa tjetër ta incizojë plotësisht dhe pa ndalesa, ndërsa incizimet ti ruaje më pakë 30 ditë pas transmetimit (Neni 144 paragrafi 1 nga Ligji);
13. Operatori që rriemeton servise programore nuk guxon ta pengojë kalimin e lirë të serviseve të radios dhe televizive që emetohen përmes transmetuesit terestrijal (Neni 144 paragrafi 2 nga Ligji);
14. Operatorët që rriemetojnë servise programore janë të detyruar që sinjalin e vet për dalje në mënyrë të vazhdueshme ta dërigojnë në lokacionin për grumbullimin e sinjaleve të lokalizuara (Neni 144 paragrafi 3 nga Ligji);
15. Operatorët ekzistues të cilët rritransmetojnë servis programor janë të detyruar që në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit në Agjencinë të dorëzojnë kërkesat për regjistrim (neni 154 paragrafi 3 nga Ligji).

Me respekt,

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale
Kryetar,**

Dr. Zoran Trajçevski

